

## AKT THEMELIMI

I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar  
“Kaizen” shpk

Në Tiranë, sot më datë 12 Nëntor 2021, në cilësinë e “ortakut themelues”:

Z. Ermir Drini Mamaqi, i ditëlindjes 20.10.1985, lindur në Tiranë, Shqipëri, dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi jurdike dhe për të vepruar, mbajtes karte identitetime numer 032451024 i cili me cilësinë e “ortakut themelues”, me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, hartoï këtë akt themelimi për krijimin e shoqërisëme përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “Kaizen” shpk mbeshtetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqeritë tregtare” tëndryshuar me ligjin 129/2014, në ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

### KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqëria “Kaizen” shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”). Emri tregtar i shoqerisë “Kaizen” shpk

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “Kaizen” shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortakët e shoqërisë”, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gjëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka selinë kryesore në Tiranë, në adresën Rruga Shyqyri Brari, Tek Kopshti

Zoologjik, Selitë Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Shoqërisë.

#### Neni 4

##### Objekti i veprimtarisë

*Organizim dhe menaxhim, konferencash, eventesh, seminare, trajnimesh etj. Sherbime të perkthimit. Sherbime kateringu. Printime, kancelari. Zhvillimi i aktivitetit të hotelerit turizmit, menaxhim hotelerie, agjensi turistike, transport pasajeresh.*

*Shërbime konsulencë në fushën e marketingut, menaxhimit, konsulencë e përgjithshme biznesi.*

*Shërbime ndërmjetësimi tregtar, agjent tregtar etj. Të kryejë aktivitete publikimi, reklamimi, shitje, blerje online.*

*Përgatitjen, prodhimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e faqeve të internetit dhe faqeve sociale si dhe realizimin e fushatave reklamuese. Makina me qera, transport me automjete dhe me shofere, asistencë profesionale për organizimin dhe zhvillimin e aktivitetave të tjera në fushën e biznesit, kulturës, sportit etj.*

*Shoqëria mund të zhvillojë cfaredo lloj aktiviteti tjeter që e lejon ligji.*

#### Neni 5

##### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore te papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

#### **KREU II**

#### **KAPITALI**

#### Neni 6

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 200.000 lekë.

Kapitali i mësiperështë nënshkruar dhe do të shlyhet apo tē hapen llogaritë bankare të shoqërisëtërsisht në të holla nga "ortakët shoqërisë" e shoqërisë :

**Z. Ermir Drini Mamaqi**, është zotëruar i 1 kuote me vlerë 200.000 lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo tē drejta)

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

## Neni 7

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asambleja e Ortakut në të njëjtat kushte që kërkojen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

## Neni 8

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

## Neni 9

### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakutështë organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakutështë organi vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit

sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet prane QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Ortakut, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcactimin e shpërblimeve;
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistraura në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 10

#### Administrimi

Administratorii shoqërisështë: Z.Ermir Drini Mamaqi

Administratorii shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asambleja e Ortakut të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

#### Neni 11

#### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakut;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto

- dokumente përpara Asambleja e Ortakut për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e vprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshtë i detyruar të thërrasë mbledhjen e Asambleja e Ortakut edhe ne rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratorii ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratorii përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrave te tatim taksave, autoritetet doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratorii angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## Neni 12

### Pergjegjesite

Administratori eshtë përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakut që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyras së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administratori, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

#### Neni 13

#### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

#### Neni 14

#### Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asambleja e Ortakut, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asambleja e Ortakut vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### Neni 15

#### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "Kaizen" shpk, u redaktua me vullnetin te lire e te plete te "ortakut themelues", ne 2 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe.

#### ORTAKET E SHOQERISE

Ermir Mamaqi

Ermir Mamaqi  
